

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar i Avancuar
Advanced Financial Reporting

P9

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data
24.09.2016

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	<u>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK-PIKËT E DHËNA</u>
1. Problemi 1	25	
2. Problemi 2	15	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problemi 5	20	
Total	100	

Problemi 1

Prishtina sh.a është një distributor i produkteve ushqimore në Kosovë. Mban investime në ekuitet në këto kompani:

Presheva sh.a

Prishtina sh.a bleu 80% të aksioneve të ekuitetit në Presheva sh.a me 1 korrik 2014 kur fitimet e mbajtura dhe premia e aksioneve kishin saldo kreditore prej €12 milion dhe €10 milion respektivisht. Blerja u bë nëpërmjet një këmbimi të katër aksioneve në Presheva sh.a për çdo pesë aksione në Prishtina sh.a. Çmimet e aksioneve të Prishtina sh.a dhe Presheva sh.a në datën e blerjes ishin €2 dhe €3 respektivisht. Me 1 korrik 2014, vlerat bartëse të pasurive neto të Presheva ishin të barabarta me vlerat e tyre të drejta.

Prizreni sh.a

Prishtina sh.a bleu 40% të aksioneve të ekuitetit të Prizreni sh.a duke paguar €2 për aksion me 1 janar 2016 kur vlerat e drejta të neto pasurive të Prizreni sh.a ishin të barabarta me vlerat bartëse. Kjo blerje nuk është regjistruar nga Prishtina sh.a. e cila është financuar duke emetuar 16 mijë aksione të reja me €2 secila.

Presheva sh.a gjithashtu kishte këtë investim:

Peja sh.a

Presheva sh.a bleu 80% të aksioneve të ekuitetit të Peja sh.a për një konsideratë në para prej €20 milion me 1 korrik 2015. Në datën e blerjes, vlerat e drejta të pasurive neto të Peja sh.a ishin të barabarta me blerat bartëse me përjashtim të një zëri të impiantit të prodhimit që kishte vlerë të drejtë prej €17 milion dhe vlera bartëse e të cilit ishte €12 milion. Ky impiant kishte jetë të mbetur prej 5 viteve me 1 korrik 2015. Është politikë e Peja sh.a që të llogarisë zhvlerësimin sipas metodës drejtvizore. I tërë zhvlerësimi ngarkohet në kosto të shitjeve.

Pasqyrat e përmbledhura të pozitës financiare dhe fitimit ose humbjës për të katër kompanitë janë si në vijim:

Pasqyrat e Pozitës Financiare me 30 qershor 2016

	Prishtina	Presheva	Peja	Prizreni
	€'000	€'000	€'000	€'000
Pasuritë jo-qarkulluese	51,000	83,400	84,300	40,900
Investimet	250,000	50,000		
Pasuritë qarkulluese:				
Stoqet	15,000	15,000	10,000	8,000
Llogaritë e arkëtueshme	10,000	11,000	7,000	5,000
Banka	<u>3,000</u>	<u>2,000</u>	<u>600</u>	<u>200</u>
	329,000	161,400	101,900	54,100
Aksione të zakonshme €1 secila	250,000	120,000	80,000	40,000
Premia e aksioneve	40,000	10,000	-	
Fitimet e mbajtura	16,000	14,400	9,400	7,600
Detyrimet afatgjata:				
Detyrim i tatimit të shtyrë	14,000	7,000	4,000	2,000
Detyrimet afatshkurtëra:				
Llogaritë e pagueshme	<u>9,000</u>	<u>10,000</u>	<u>8,500</u>	<u>4,500</u>
	329,000	161,400	101,900	54,100

Pasqyrat e fitimit ose humbjës për vitin e përfunduar me 30 qershor 2016

	Prishtina	Presheva	Peja	Prizreni
	€'000	€'000	€'000	€'000
Të hyrat	200,000	130,000	80,000	60,000
Kosto e shitjeve	<u>(123,000)</u>	<u>(86,000)</u>	<u>(43,000)</u>	<u>(33,000)</u>
Fitimi bruto	77,000	44,000	37,000	27,000
Kostot e shpërndarjes	(43,000)	(24,000)	(19,000)	(13,000)
Shpenzimet administrative	(25,000)	(10,000)	(9,000)	(8,000)
Të ardhurat nga investimet	<u>8,000</u>			
Fitimi para tatimit	17,000	10,000	9,000	6,000
Tatimi në fitim	<u>(7,000)</u>	<u>(3,000)</u>	<u>(2,700)</u>	<u>(1,800)</u>
Fitimi për vitin	10,000	7,000	6,300	4,200

Informata shtesë:

- i) Me 1 korrik 2014, Presheva sh.a kishte në pronësi një liçensë të një web faqe të popullarizuar e cila mund të rinovohet pafundësisht më një kosto nominale. Liçensa nuk është njohur nga Presheva sh.a. Në datën e blerjes së Presheva sh.a nga Prishtina sh.a, një kompani e specializuar e vlerësoi liçensën €6 milion dhe përcaktoi që jeta e saj është e pakufishme.
- ii) Gjatë viti, Presheva sh.a pagoi një dividendë prej €10 milion. Prishtina sh.a kishte kredituar pjesën e saj të dividendës që e ka pranuar nga Presheva tek të hyrat nga investimet.
- iii) Gjatë vitit, Presheva sh.a shiti stoqe tek Prishtina sh.a me çmim €3 milion me një marzhë mbi kosto prej 20%. Gjysma e stoqeve mbeti pa u shitur në fund të vitit.
- iv) Prishtina sh.a shiti stoqe në vlerë prej €2 milion tek Prizreni sh.a gjatë periudhës pas blerjes duke realizuar fitim prej €1 milion. Të gjitha stoqet mbeten pa u shitur në fund të vitit.
- v) Zëri i mirë i konsoliduar i Presheva sh.a është dëmtuar për 10%. Megjithatë, zëri i mirë i Peja sh.a dhe investimet në Prizreni sh.a nuk janë dëmtuar.
- vi) Të gjitha të hyrat dhe shpenzimet ndodhin njetrajtësisht përgjatë vitit.
- vii) Prishtina sh.a llogarit zërin e mire duke përdorur metodën proporcionale.

Kërkohet:

Përgaditni pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 30 qershor 2016 dhe pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare me 30 qershor 2016.

(25 pikë)

Zgjidhja e problemit 1

1

Blerja e Presheva sh.a 80% €'000

Konsiderata e blerjës: $80\% \times 120,000 / 4 \times 5 \times 2 =$ 240,000

Minus: VDPN

Ekuiteti (120,000)

Premia e aksioneve (10,000)

Fitimet e mbajtura (12,000)

PP (6,000)

(148,000) $\times 80\%$ (118,400)

Zëri i mirë 121,600

Dëmtuar 10% 12,160

Tek PKPF **109,440**

Blerja e Peja sh.a nga Presheva sh.a (80 x 80 = 64%) €'000

Konsiderata e blerjës $20,000 \times 80\%$ 16,000

Minus: VDPN

Ekuiteti (80,000)

Fitimet e mbajtura (3,100)

Korigjimet e VD (5,000)

$88,100 \times 64\%$ (56,384)

Zëri i mirë negativ **40,384**

Investimet në Prizreni sh.a 40% €'000

Kosto e investimit $40\% \times 40,000 \times 2$ 32,000

Pjesa e fitimeve pas blerjës $2,100 \times 40\%$ 840

Minus: FPR $1000 \times 40\%$ (400)

Vlera bartëse e investimeve në ortakëri **32,440**

Fitimet e mbajtura – Presheva sh.a €'000

Saldo në fillim 14,400

Fitimet para blerjës $(12 \times 80\%)$ (9,600)

FPR – stoqet (250)

IJK $- 14,400 - 250 \times 20\%$ (2,830)

Tek fitimi i mbajtur i konsoliduar **1,720**

IJK- Presheva sh.a 20% €'000

Ekuitetit 24,000

Premia e aksioneve 2,000

PP 1,200

Fitimet e mbajtura	<u>2,830</u>
Tek PKPF	30,030
Fitimet e mbajtura –Peja	€'000
Saldo në fillim	9,400
Fitimet para blerjës	(1,984)
Zhvlerësimi shtesë	(1,000)
IJK 9,400 – 1,000 x 36%	<u>(3,024)</u>
Tek fitimi i mbajtur i konsoliduar	3,392

IJK Peja sh.a 36%	€'000
Ekuiteti	28,800
Investimet 20,000 x 20%	(4,000)
Fitimet e mbajtura	3,024
VD korigjimet	<u>1,800</u>
Te PKPF	29,624

Fitimi i mbajtur i konsoliduar	€'000
Saldo në fillim	16,000
Nga Presheva sh.a	1,720
Nga Peja sh.a	3,392
Nga Prizreni sh.a	840
Zëri i mirë negativ	40,384
Zëri i mirë i dëmtuar	(12,160)
FPR –ortakëria	<u>(400)</u>
Tek PKPF	49,776

Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjës për vitin e përfunduar me 30 qershor 2016

	€'000
Të hyrat 200,000 + 130,000 + 80,000 – 3,000	407,000
KSH 123,000 + 86,000 + 43,000 – 3,000 + FPR 250 + zhvl. 1,000	<u>(250,250)</u>
Fitimi bruto	156,750
Kostot e shpërndarjes 43,000 + 24,000 + 19,000	(86,000)
Shpenzimet administrative 25,000 + 10,000 + 9,000	(44,000)
Shpenzimet tjera – zëri i mirë i dëmtuar	(12,160)
Zëri i mirë negativ	40,384
Pjesa e fitimi të ortakërisë 2,100 x 40% - FPR 400	<u>440</u>
Fitimi para tatimit	55,414
Tatimi 7,000 + 3,000 + 2,700	<u>(12,700)</u>
Fitimi për vitin	42,714

Fitimi i vitit i atribuar tek:

IJK Presheva 7,000 – FPR 250 x 20% =	1,350
Peja 6,300 – 1,000 x 36% =	1,908
Prindi	<u>39,456</u>
	42,714

Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare me 30 qershor 2016

	€'000
Pasuritë jo-qarkulluese 51,000 + 83,400 + 84,300 + VD 5,000 – 1,000	222,700
Pasuritë e paprekshme	6,000
Zëri i mire	109,440
Investimet 10,000 + 30,000	40,000
Investimet në shoqëri	<u>32,440</u>
	410,580
Pasuritë qarkulluese	
Stoqet 15,000 + 15,000 + 10,000 - FPR 250	39,750
Llogaritë e arkëtueshme 10,000 + 11,000 + 7,000	28,000
Banka 3,000 + 2,000 + 600	<u>5,600</u>
	483,930
Rezervat e ekuitetit	
Ekuiteti 250,000 + 16,000	266,000
Premia e aksioneve	56,000
Fitimet e mbajtura të konsoliduara	49,776
IJK 30,030 + 29,624	59,654
Tatimit i shtyrë 14,000 + 7,000 + 4,000	25,000
Llogaritë e pagueshme 9,000 + 10,000 + 8,500	<u>27,500</u>
	483,930

Problemi 2

a) Me 1 korrik 2016, Xhaka, një kompani e listuar në bursë që shet paisje të rënda, ka huazuar fonde për tu zgjeruar nëpërmjet emitimit të 10 milion 5% obligacione të konvertueshme me vlerë nominale prej €500 secila. Obligacionet do të ripaguhën në fund të pesë viteve. Secili obligacion është i konvertueshëm në aksione në opcion të mbajtësit në çdo kohë gjatë periudhës pesë vjeçare. Interesi në obligacione do të paguhet çdo vit në fund të vitit.

Normat e interesit që mbizotëronte në treg për borxhe të ngjajshme pa të drejtë konvertimi në datën e emitimit është 6%. Faktori i skontimit për 6% për vitin 5 është 0.747 dhe faktori kumulativ i skontimit për vitet 1 deri 5 është 4.212.

Kërkohet:

(i) Shpjego si një obligacion i konvertueshëm duhet të paraqitet në pasqyrat financiare.

(3 pikë)

(ii) Llogarite shumën që duhet të njihet në pasqyrat financiare të Xhaka sh.a në datën e emitimit siç kërkohet me SNK 32 Instrumentet Financiare: Prezantimi.

(5 pikë)

b) Ju është kërkuar nga zyrtari kryesor i kompanisë tuaj që të jepni një opinion lidhur me trajtimin në kontabilitet të secilit skenar të listuar më poshtë. Përgjigja e juaj duhet të bazohet në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Supozo që për të gjitha skenarët fundi i vitit është 30 qershor 2016.

i) Kompania shet kompjuter të cilët kanë një vit garancion nga prodhuesi. Megjithatë, kompania gjithashtu u ofron klientëve të saj mundësinë e blerjes me garancion të zgjatur për dy vite tjera. Çmimi shitës i garancionit të zgjatur është €600. Bazuar në përvojat e kaluara, kompania pret që do të ketë kërkesa për garancion nga 5% të klientëve gjatë periudhës së zgjatur të garancioneve. Kosto mesatare të shërbimit të secilit garancion është €1,200.

(4 pikë)

ii) Gjatë vitit, departamenti i rrezikut dërgoi stafin e tij në një kurs të trajnimit që kushtoi €150,000. Trajnimi ka përmirësuar eficiencën e stafit e cila më pas ka rezultuar me kursime në kosto. Organizatori ka theksuar që përfitimet nga trajnimi duhet të zgjasin minimum dy vite. Asistenti i kontabilitetit si pasojë ka trajtuar koston e trajnimit si pasuri të paprekshme dhe ka amortizuar koston e trajnimit përgjatë kohëzgjatjes së pritur të përfitimeve si rezultat i trajnimit.

(3 pikë)

(15 pikë)

Zgjidhja e problemit 2

2.

a)

i) Një borxh i konvertueshëm është një shembull i një instrumenti financiar i cili ka në vete më shumë se një instrument financiar. Duke qenë instrument i përbërë mbajtësit i është dhënë opioni që ose ta konvertoj borxhin në aksione ose të pranoj pagesën në para. Andaj një borxh i konvertueshëm nuk duhet thjeshtë të regjistrohet si detyrim (sipas përkufizimit) por duhet të regjistrohet duke u bazuar në substancën e marrëveshjes kontraktuale. Një borxh i konvertueshëm përbëhet nga dy komponentë: një detyrim financiar (marrëveshja kontraktuale për të paguar para) dhe një instrument të ekuitetit (opcionin për tu konvertuar në aksione) dhe si pasojë duhet të paraqitet pjesërisht si detyrim dhe pjesërisht si ekuitet në pasqyrat financiare.

ii) Pasi që është një instrument financiar hybrid duhet të njihet në pasqyrën e pozitës financiare pjesërisht si borxh dhe pjesërisht si ekuitet. Majtja e elementit të ekuitetit është vlera e mbetur pas kalkulimit të vlerës së tanishme të detyrimit duke përdorur normën që mbizotëron në treg prej 6%.

	€'000
Vlera e tanishme e kryegjësë ($10,000,000 \times 500 \times 0.747$)	3,735,000
Vlera e tanishme e pagesave të interesit ($5,000,000 \times 5\% \times 4.212$)	<u>1,053,000</u>
	4,788,000

	€'000
Elementi i borxhit	4,788,000
Elementi i ekuitetit	<u>212,000</u>
	5,000,000

b)

(i) Shitja e garancionit të zgjatur duhet të trajtohet sipas fazës së kompletimit. Pra shuma e pranuar duhet të njihet në baza drejtvizore përgjatë periudhës së garancionit të zgjatur. Kosto e shërbimit të garancionit duhet të njihet si kosto e shitjes kur të ndodh.

Kompania duhet të sigurohet që shuma e të hyrave të shtyera e bartur në periudhën tjetër është e mjaftueshme për të mbuluar kostot e pritshme në të ardhmën për garancione. Nëse shuma nuk është e mjaftueshme, kontrata për garancionin e zgjatur bëhet kontratë që shkakton humbje dhe duhet të kontabilizohet në pajtim me SNK 37.

(ii) Shpenzimet e kursit të trajnimit shfaqin karakteristika të një pasurie sepse do të vazhdojnë të sjellin përfitime ekonomike në të ardhmen duke rritur eficiencën dhe kursyer kostot. Megjithatë SNK 38 nuk lejon që shpenzimet e trajnimit të njihen si pasuri dhe duhet të trajtohen si shpenzime posa të shkaktohen kostot. Arsyeja ka të bëjë me çështjen e “kontrollit”. Punonjësit kanë aftësitë e marra nga trajnimi por mund të largohen nga kompania dhe t'i marrin me vete apo nëpërmjet aksidentit apo lëndimeve mund të mos jenë në gjendje që t'i shfrytëzojnë aftësitë.

Problemi 3

Informatat në vijim kanë të bëjnë me Batllava sh.p.k një filial të huaj të Ontario sh.a.

Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2015	€
Pasuritë jo-qarkulluese sipas kostos	2,250,000
Minus: Zhvlerësimi	<u>(900,000)</u>
	1,350,000
Stoqet	900,000
Llogaritë e arkëtueshme	<u>450,000</u>
	2,700,000
Aksionet e zakonshme	450,000
Fitimet e mbajtura	<u>1,260,000</u>
	1,710,000
Borxhi	495,000
Llogaritë e pagueshme	247,500
Tatimi i pagueshëm	<u>247,500</u>
	2,700,000

Llogaria e fitimit ose humbjës për vitin e përfunduar 2015	€
Fitimi para tatimit	720,000
Tatimi	<u>360,000</u>
Fitimi pas tatimit	360,000

Informata tjera relevante:

- (i) Kurset e këmbimit ishin
 - €75 për \$1 kur kompania u themelua
 - €62.5 për \$1 kur kompania bleu pasuritë e saj jo-qarkulluese
 - €50 për \$1 me 1 janar 2015
 - €40 për \$1 mesatarja gjatë vitit të përfunduar me 31 dhjetor 2015
 - Kursi i këmbimit me 31 dhjetor 2015 ishte €25 për \$1
- (ii) Zhvlerësimi është në normën prej 12% në vit
- (iii) Stoqet në fillim të Batllava sh.p.k ishin €540,000
- (iv) Ontario sh.a bleu të gjithë kapitalin aksionar të Batllava sh.p.k, për \$8,000 kur rezervat e saj ishin zero.
- (viii) Valuta e paraqitjes e Ontario sh.a reporting është USD (\$).

Kërkohet:

Kërkohet të përktheni për tu përfshirë në pasqyrat e konsoliduara financiare:

- a) Pasqyrën e pozitës financiare të Batllava Plc. me 31 dhjetor 2015. (10 pikë)**
- b) Pasqyrën e fitimit ose humbjës për vitin e përfunduar 2015. (5 pikë)**
- c) Shpjego shkurtimisht kur mund të ndërrohet valuta funksionale e një entiteti. (5 pikë)**

(Total: 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 3

3

Hapi 1

Përkthe Pasqyrën e Pozitës Financiare duke përdorur kursin përfundimtar për të përkthyer të gjitha pasuritë dhe detyrimet. Përkthe Kapitalin aksionar dhe rezervat para blerjes em kursin historic. Zeri i mirë duhet të trajtohet si pasuri neto e filialit.

Pasqyra e përkthyer e Pozitës Financiare e Batllava sh.a me 31 dhjetor 2015

	€	FX	\$
Pasurite e prekshme jo-qarkulluese	2,250,000	25	90,000
Zhvleresimi	<u>(900,000)</u>	25	<u>(36,000)</u>
	1,350,000		54,000
Stoqet	900,000	25	36,000
LI/ A	450,000	25	18,000
Minus: Detyrimet afatshkurtera			
LI/P	247,500	25	9,900
	<u>247,500</u>	25	<u>9,900</u>
	(495,000)		(19,800)
Total pasurite minus detyrimet afatshkurtera	2,205,000		88,200
Kredite	<u>(495,000)</u>	25	<u>(19,800)</u>
	1,710,000		68,400
Aksionet e zakonshme	450,000	75	6,000
Rezervat para blerjes	-	75	-
Rezervat pas blerjes	<u>1,260,000</u>	Saldo	<u>62,400</u>
	1,710,000		68,400

Hapi i dyte

Llogaritja e zërit të mirë në blerje

Kosto e blerjes €75 x 8,000	600,000
Kapitali aksionar	(450,000)
Rezervat para blerjes	-
Zeri i mirë	150,000

Zeri i mirë do të përkthehet sipas kursit përfundimtar €150,000/25 = \$6,000

Hapi i tretë

Perkthe pasqyren e fitimit dhe humbjes per vitin e perfunduar me 31 dhjetor 2015

	€	FX	\$
Fitimi parar tatimit	720,000	40	18,000
Tatimit	<u>(360,000)</u>	40	<u>(9,000)</u>
Fitimi pas tatimit	360,000		9,000

Hapi i katërt

Fitimi në riperkthimin e zërit të mirë

Zëri i mirë i përkthyer me 31 dhjetor 2014	150,000/50 =	\$3,000
Zëri i mirë me 31 dhjetor 2015		<u>\$6,000</u>
Fitimi nga perkthimi		\$3,000

Hapi i peste

Llogaritja e fitimeve nga këmbimi

Pasurite jo-qarkulluese sipas kursit fillestar	€1,350,000/50 =	\$27,000
Pasurite jo-qarkulluese sipas kursit përfundimtar	€1,350,000/25 =	<u>\$54,000</u>
Fitimi nga perkthimi		\$27,000

Levizjet ne ekuitet gjate vitit	€360,000	
Fitimi i periudhes me kursin mesatar	€360,000/40 =	\$9,000
Fitimi i periudhes me kursin përfundimtar	€360,000/25 =	<u>\$14,400</u>
Fitimi nga perkthimi		<u>\$5,400</u>

	\$32,400
Fitimi nga perkthimi i zërit të mire	<u>\$3,000</u>
	\$35,400

c) Valuta funksionale e një entiteti mund të ndryshohet vetëm në qoftë se ka një ndryshim në transaksionet, ngjarjet dhe kushtet mbi të cilat ndërtohen pasqyrat në fjalë dhe që kanë rëndësi për entitetin. Për shembull, valuta funksionale e një entiteti mund të ndryshojë në qoftë se valuta e cila influencon kryesisht çmimet e shitjes të mallrave dhe shërbimeve ndryshon.

Në rastet kur ka një ndryshim në valutën funksionale të një entiteti, entiteti në fjalë bën përkthimin e të gjithë zërave në valutën e re funksionale në mënyrë prospektive (pra, duke filluar nga data e ndryshimit) duke përdorur kursin e këmbimit valutor në datën e ndryshimit.

Problemi 4

a) Duke u bazuar në kornizën e BNSK-së, trego për secilën pikë më poshtë nëse përmbush përkufizimin e një 'pasurie' apo një 'detyrimi' dhe nëse ka gjasa që kriteret e njohjes të përmbushën. Shpjego përgjigjën tënde. Referoju vetëm kornizës dhe jo ndonjë SNK/SNRF-je specifike që mund të jetë e aplikueshme .

- i) një kontratë për të derguar 1,000 tonelata të patateve për € 20 për 100 kg pas tre muajve. Çmimi aktual i tregut është € 15 për 100 kg.
- ii) një kontratë për të derguar 1,000 tonelata të patateve për € 10 për 100 kg pas tre muajve. Çmimi aktual i tregut është € 20 për 100 kg.
- iii) shpenzimet të mëdha për përgaditjen e ofertës për një kontratë të madhe (në datën e pasqyrës së pozitës financiare oferta është dorëzuar, afati për të dorëzuar ofertën tani është mbyllur, por ende nuk dihet se kush do ta fitoj kontratën.)
- iv) vlera bartëse (vlera në libra) e një impianti të energjisë elektrike të shkatërruar në një aksident. Kompania e energjisë elektrike operon në një treg të rregulluar nga qeveria. Ka një monopol regional dhe e di që qeveria do ta lejoj që të rrisë çmimin e energjisë elektrike në të ardhmen për të rikuperuar humbjet e impiantit.

(10 pikë)

- (b) Nga perspektiva e entitetit raportues dhe e përdoruesit të raporteve vjetore, diskuto përparësitë dhe mangësitë e komenteve të detyrueshme të menaxhmentit si pjesë e raportit vjetor.**
(5 pikë)
- (c) Shpjego kriteret që duhet të përmbushën që një detyrim financiar të njihet sipas kostos së amortizuar në pasqyrat financiare.**
(5 pikë)

(Total: 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 4

4.

i)

Dy mënyra të mundshme për të iu qasur: (1) Kontrata është një gjë e vetme. Në këtë rast mund të shikohet si pasuri: resurs (ndoshta, edhe pse kjo nuk është e përkufizuar në Kornizë), kontrolluar (po), ngjarje e kaluar (po) përfitime të ardhshme të pritura (po). Njohja: rrjedhë e mundshme e përfitimeve (po), kosto apo vlerë që mund të matet me besueshmëri (ndoshta jo kosto, por vlerësimi duket i mundshëm). (2) Kontrata krijon të drejtën edhe në pasuri (të drejtën për të pranuar para) dhe në detyrim (obligimin për të dërguar patate). Por që të dyja me siguri që përmbushin përkufizimet përkatëse në Kornizë (për pasuri si më lartë, për detyrim: obligim i tanishëm (po), ngjarje e kaluar (po), dalje e resurseve ekonomike (po), si dhe kriteret e njohjes (dalje/hyrje të mundshme dhe matje me besueshmëri, së paku të vlerës). Në këtë rast, megjithatë, mund të verëhet që kontrata është reciprokisht e papërmbushur dhe si rrjedhojë mund të mos njihet sipas Kornizës. [Në SNK 37 por jo në Kornizë, kjo quhet kontrate ekzekutuese].

ii)

Nëse shikohet si një gjë e vetme (shih i): përmbush përkufizimin e detyrimit (por një pasqyrë e pasurisë), konsideratë e ngjajshme e kriterëve të njohjes. Nëse shikohet si një kombinim i pasurive dhe detyrimeve, korniza anon më shumë drejt njohjes së një detyrimi në ii). se sa një pasurie sipas i)., [edhe pse korniza nuk thotë me shumë se 'kontratat me humbje të ekzekutueshme normalisht duhet të njihen']

iii)

Përmbush përkufizimin e pasurisë (thjesht sepse, pasi që oferta është dorëzuar, kompania ka një probabilitet të përfitimeve në të ardhmen, të cilat nuk do ti kishte ndryshe: oferta e dorëzuar në parim është diçka që ndonjë blerës potencial do ta konsideronte relevante), por mund të mos e përmbush kriterin e njohjes (në veçanti: probabiliteti i ulët, por ndoshta vështirësia e matjes së besueshme). Korniza nuk ka përkufizim të përgjithshëm të 'e mundshme'.

iv)

Impianti nuk është më pasuri (nuk ka përfitime në të ardhmen) ose përfitimet në të ardhmen do të jenë më të uleta sesa vlera bartëse (ndoshta ndonjë vlerë si mbeturinë, pra vlera origjinale e bartur do të duhet normalisht të c'njihet, sipas kornizës. Megjithatë, e drejta për t'i rritur normat ndoshta duhet të konsiderohet si një pasuri. Kjo do të varej nga kontrolli, p.sh. aka garancione eksplicite që normat mund të rriten mjaftueshëm? A mundet qeveria ta revokoj monopolin?. Gjatë vlerësimit probabilitetit të përfitimeve të ardhshme, gjerat si mundësia që

klientët të kalojnë në burime alternative të energjisë duhet të mirrën parasysh. Këto janë gjërat që BNSK është aktualisht duke menduar në projektin për 'industrinë me norma të rregulluara'

b)

Përparësitë

Entiteti

- Promovon entitetin, dhe tërheq investorët, huadhënësit, klientët dhe furnitorët
- Komunikon planet dhe pikëpamjet e menaxhmentit

Përdoruesit

- Pasqyrat financiare nuk mjaftojnë për të marrur vendime (vetëm informata)
- Pasqyrat financiare shikojnë vetëm prapa (nevoja për informata që shikojnë përpara)
- Thekson rreziqet
- E dobishme për krahasueshmëri me entitetet tjera

Mangësitë

Entiteti

- kostot mund të jenë më të mëdha se përfitimet
- Paraqet rrezik që investorët të injorojnë pasqyrat financiare financiare)

Përdoruesit

- Subjektive
- Zakonisht nuk auditohen
- Mund të nxisin kompanitë që të delistohen (të evitojnë kërkesat për të përgaditur KM)
- Vendet e ndryshme kanë nevojë të ndryshme

c)

Ky është një klasifikim i kufizuar pasi që aplikohet vetëm për instrumentet e borxhit dhe jo për instrumentet e ekuitetit. Instrumentët e ekuitetit mund të klasifikohen ose sipas vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjës ose sipas vlerës së drejtë nëpërmjet të ardhurave gjithëpërfshirëse. Instrumenti i borxhit nuk duhet të mbahet thjesht vetëm për tu shitur. Kjo do të thotë që një entitet nuk duhet ta blejë atë për të vetmin qëllim që të realizoj vlerën nëpërmjet shitjes. Për më tepër, dy testet e modelit të biznesit dhe dhe rrjedhës së pasasë duhet të përmbushen. Sipas testit të karakteristikave të rrjedhës së pasasë, kushtet e kontratës së pasurisë financiare duhet të krijojnë të drejta në datat e specifikuar në rrjedha të pasasë të cilat janë vetëm pagesa të kryegjësë dhe interesit në kryegjënë e papaguar. Përderisa sipas testit të modelit të biznesit, një pasuri financiare mbahet sipas modelit të biznesit objektivit i të cilit arrihet edhe duke i arkëtuar rrjedhat e pasasë edhe duke shitur pasurinë financiare.

Problemi 5

a) Gjatë vitit 2015 Hulumtimi sh.p.k kishte në progress projektet në vijim të hulumtimit dhe zhvillimit.

Projekti A ishte përfunduar në fund të vitit 2014. Saldo e shpenzimeve të zhvillimit në fillim të vitit 2015 ishte €412,500 për këtë projekt. Kursimet në kostot e prodhimit që rrjedhin nga ky projekt pritet të ndodhin për herë të parë në vitin 2015. Në vitin 2015 kursimet pritet të jenë €100,000, të përcjellura me kursimet prej €300,000 në vitin 2016 dhe €200,000 në vitin 2017.

Projekti B filloi me 1 prill 2015. Kostot e shkaktuara gjatë vitit ishin €56,000. Përveq këtyre kostove edhe një makinë është blerë me 1 prill 2015 për €30,000 për përdorim në projekt. Kjo makinë ka një jetë të përdorimit prej pesë viteve. Në fund të vitit 2015 kishte ende paqartësi lidhur me përfundimin e projektit.

Projekti C ka filluar në vitin 2014. Në vitin 2014 kostot që kishin të bënin me këtë projekt prej €36,700 janë shlyer, pasi që në fund të vitit 2014 kishte ende paqartësi lidhur me kompletimin e projektit. Këto paqartësi tani janë hequr dhe janë shkaktuar kosto shtesë prej €45,000 gjatë vitit 2015.

Kërkohet:

Tregoni se si duhet të paraqiten të mesipërmet në pasqyrat financiare (përfshirë shënimet e pasqyrave financiare) të Hulumtimi sh.p.k me 31 dhjetor 2015. (10 pikë)

b) Fabrika sh.a, prodhon pesë produkte të teknologjisë së lartë, secila në fabrikë të ndryshme. Fabrika sh.a është në process të përgaditjes së pasqyrave financiare për vitin e përfunduar me 30 qershor 2016. Ju jeni Drejtor Ekzekutiv i kompanisë, dhe cështjet në vijim duhet t'i merrni në konsideratë:

(i) Stoqet me vlerë bartëse prej €25 milion në 30 qershor 2016 janë shitur më pas për €15 milion pasi që ishin dëmtuar nga vërshimet në korrik 2016.

(ii) Me 5 korrik, 2016 një nga klientet e medhënj të Fabrika sh.a deklaroi bankrotim. Likuidatori deklaroi me 25 gusht 2016 që 20% e borxhit do te paguhet gjatë likuidimit.

(iii) Një produkt i ri që u fut në treg nga një konkurrent me 1 gusht 2016 kishte shkaktuar një rënie të madhe në kërkesën e tregut për një nga produktet kryesore të Fabrika sh.a. Si rezultat, Fabrika sh.a është duke konsideruar një ulje në çmim dhe zvogëlim të prodhimit.

(iv) Me 18 gusht 2016 qeveria njoftoi një rritje retrospektive në normën e tatimit që aplikohet për kompaninë.

(v) Drejtorët e Fabrika sh.p.k deklaruan dividend prej €3 për aksion me 28 gusht 2016.

Kërkohet:

Tregoni se si ngjarjet e mësipërme duhet të trajtohen në pasqyrat financiare të Fabrika sh.a për vitin e përfunduar me 30 qershor 2016. Ju mund të supozoni që ngjarjet e mësipërme janë materiale për kompaninë. (10 pikë)

Totali 20 pikë

Zgjidhja e problemit 5

5.

a) **Pasuritë e patundshme, impiantet e prodhimit dhe paisjet**

Impiantet e prodhimit dhe paisjet

	Kosto €
Me 1 janar 2015	X
Shtesat	<u>30,000</u>
Me 31 dhjetor 2015	X

Zhvlerësimi i akumuluar

Me 1 janar 2015	X
Ngarkesa për vitin ($30,000 \times 9/12 \div 5$)	<u>4,500</u>
Me 31 dhjetor 2015	X

Vlera bartëse

Me 31 dhjetor 2014	X
Me 31 dhjetor 2015	25,500

Pasuritë e paprekshme

Shpenzimet e zhvillimit dhe hulumtimit të gjeneruara nga brenda

	Kosto €.
Me 1 janar 2015	412,500
Shtesat	<u>45,000</u>
Me 31 dhjetor 2015	457,500

Zhvlerësimi i akumuluar

Me 1 janar 2015	-
Ndryshimi për vitin (LI)	<u>68,750</u>
Me 31 dhjetor 2015	68,750

Vlera bartëse

Me 31 dhjetor 2014	412,500
Me 31 dhjetor 2015	388,750

Llogaritja

Zhvlerësimi i Projektit A

	€
Total kursimet ($100,000 + 300,000 + 200,000$)	600,000
Ngarkesa e zhvlerësimit 2015 ($100,000/600,000 \times 412,500$)	68,750

Shënime:

Kostot e Projektit B nuk mund të kapitalizohen pasi që ka paqartësi lidhur me suksesin e projektit – por makineria e blerë mund të kapitalizohet në pajtim me SNK 16.

Kostot e vitit 2015 sa i perket Projektit C mund të kapitalizohen pasi që paqartësitë tani janë hequr, Megjithatë, kostot e vitit 2014 nuk mund te kapitalizohen.

b)

(i) Pasi që ngjarja e cila ka shkaktuar që stoqet të shiten me humbje ka ndodhur pas fundit të vitit, atëherë kjo është një ngjarje jo-korrigjuese. Megjithatë efekti i ngjarjes duhet të shpaloset në pasqyrat financiare të vitit që përfundoi me 30 qershor 2016.

(ii) Është një ngjarje korrigjuese në pajtim me kërkesat e SNK 10. Saldo e të arkëtueshmeve duhet të shlyhet për 80% të shumës.

(iii) Është një ngjarje jo-korrigjuese pasi që rënia e mëpasme e çmimit është për shkak të një ngjarje, futja në treg të një produkti konkurrues, që ka ndodhur pas periudhës raportuese.

(iv) Pasi që ky ndryshim nuk ka hyrë në fuqi para periudhës raportuese, është një ngjarje jo-korrigjuese. Megjithatë, një shpalosje duhet të behet për këtë ndryshim.

(v) Pasi që deklarata është bërë publike pas përfundimit të vitit dhe nuk ka pasur obligim në fund të vitit është një ngjarje jo-korrigjuese. Detajet e deklarimit të dividendës duhet të shpalosen.